



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 314, Datë 06.11.2023

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 62, DATË 08.04.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERA HYDRO” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STTORI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 KW

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2234/2 prot., datë 03.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 62, datë 08.04.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “ERA HYDRO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Sttori” me kapacitet të instaluar 2000 kW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 62, datë 08.04.2020, vendosi të licencojë shoqërinë “ERA HYDRO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Sttori”, me kapacitet të instaluar 2000 kW, për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitohet në ERE brenda datës 16.11.2022, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga Hec “Sttori”.
- ERE me shkresën nr. 1837 prot., datë 19.10.2022 i ka kujtuar shoqërisë detyrimin e lënë në pikën 3 të vendimit të bordit për të depozituar lejen e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor brenda datës 16.11.2022.
- Me shkresën me nr. 2051 prot., datë 07.12.2022, ERE duke iu referuar korrespondencës me AMBU-në, e cila ka konfirmuar se shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k. ka aplikuar për leje dhe është në fazën e trajtimit nga organet e menaxhimit të burimeve ujore. ERE i kërkoi shoqërisë që të depozitohet aplikimin e bërë pranë AMBU-së për pajisjen me lejen e

- përdorimit të burimit uxor sipërfaqësor i cili duhet të përmbajë dhe datën e kryerjes së aplikimit.
- Në përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2051/1 prot., datë 21.12.2022 shoqëria ka depozituar aplikimin e bërë pranë AMBU-së për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit uxor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga hec “Strori”, i cili nuk përmban datën e aplikimit.
 - ERE me shkresën nr. 2051/2 prot., datë 30.12.2022 i ka kërkuar shoqërisë të depozitohet aplikimin e bërë pranë AMBU-së ku në përmbajtje të tij të jetë edhe data e kryerjes së aplikimit në kuadër të rishikimit të vendimit.
 - Nga aksesimi online i *Regjistrit të lejeve/autorizimeve për përdorim burimi uxor për prodhim hidroenergjie* të përditësuar nga AMBU në muajin korrik 2023, rezultonte se shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k. disponon leje të përdorimit të burimit uxor të rinovuar që më datë 06.03.2023 me afat vlefshmërie deri më 05.03.2028.
 - ERE i'u drejtua shoqërisë me shkresën me nr. 2234 prot., datë 04.10.2023, dhe me e-mail në datën 19.10.2023 me kërkesën për të depozituar lejen e rinovuar për përdorimin e burimit uxor sipërfaqësor.
 - Me shkresën me nr. 2234/1 prot., datë 24.03.2023, shoqëria depozitoi lejen e përdorimit të burimit uxor sipërfaqësor me nr. Serie 000114, nr. 248 prot., datë 10.03.2023, të miratuar me vendimin nr. 9, datë 06.03.2023, të Këshillit të Basenit Uxor Seman për përdorim të burimit uxor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik nga Hec “Strori”, me afat 5-vjeçar, me afat vlefshmërie deri më 05.03.2028.
 - Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 62/2020, por duke qënë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe, po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshohet, duke i lënë kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit uxor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga Hec “Strori” brenda datës 05.03.2028.
 - Për sa i përket pikës 2 të këtij vendimi ku kërkohet që shoqëria të depozitohet në ERE, jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të saj kontratën e qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, të rinovuar, vlerësojmë që kjo pikë të ndryshohet duke i lënë kusht shoqërisë të depozitohet në ERE, kontratën e qirasë të rinovuar të truallit ku ushtrohet veprimtaria brenda datës 26.10.2027.
 - Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 62/2020, ndryshon dhe bëhet:
2. Shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e qirasë të rinovuar të truallit ku ushtrohet veprimtaria brenda datës 26.10.2027.

2. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 62/2020, ndryshon dhe bëhet:
3. Shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Strori” brenda datës 05.03.2028.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

KRYETARI

Petrit AHMETI